



115. 260. 746. 2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

KONTRATË

Nr. 2552 / datë 19.07.2022
115

Me objekt: "PROGRAM DIGITALIZIMI I ARKIVAVE TË GJYKATAVE"

PALET KONTRAKTORE

KONTRAKTOR
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR
PERSON I AUTORIZUAR/ TITULLARI I
AUTORITETIT KONTRAKTOR

Z. RUDINBAQLI



KONTRAKTUESI
"PC STORE"
PËRFAQËSUES I OPERATORIT
EKONOMIK

Z. VITATOR MEHMETI

K O N T R A T Ë

“PROGRAM DIGITALIZIMI I ARKIVAVE TË GJYKATAVE”

Lidhur sot më datë 19.07.2022, në bazë të nenit 772, e vijues të Kodit Civil, ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 ‘Për miratimin e rregullave të prokurimit publik’, i ndryshuar, nën vullnetin e plotë dhe të lirë, midis **Këshillit të Lartë Gjyqësor**, me adresë: Rr. “Ana Komnena”. Godina. “Poli i Drejtësisë”, Tiranë, përfaqësuar nga Z. Rudin Baqli, Person i Autorizuar/ Titullari i Autoritetit Kontraktor, përfaqësues i vetëm në rolin e blerësit dhe Autoritetit Kontraktues që më poshtë do të quhet **“Blerësi”**

Dhe:

Operatorit Ekonomik **“PC STORE”, SH.P. K**, me adresë: Rruga e Dibrës, vila 153, kati 1, 1001, Tiranë. Shqipëri, përfaqësuar nga Z. Vitor Mehmeti, që më poshtë do të quhet **“Kontraktuesi”**.

Palët bien dakort si vijon:

NENI 1


Qëllimi i kontratës

1. “Program digitalizimi i arkivave të gjykatave”, zhvilluar me anë të procedurës së Prokurimit, Procedurë e Hapur, Mbi kufirin e Lartë Monetar- Shërbime, për nevojat e Këshillit të Lartë Gjyqësor, viti buxhetor 2022 - 2024.

NENI 2

Baza ligjore

1. Ligji nr. 7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të RSH-së”, i ndryshuar, Kreu XV të Ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Kreu XIII e VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Ligji nr. 44/2015 “Për Procedurat Administrative në RSH”, i ndryshuar.



PËRMBAJTJA E KONTRATËS

NR. EMËRTIMI

Termet dhe Kushtet e Kontratës (TKK)

- Shtojca 1. Formulari i Ofertës
- Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës
- Shtojca 7: Formulari i Specifikimeve Teknike/ Termet e Referencës
- Shtojca 6. Formulari i Sasisë dhe Grafikut i lëvrimit
- Shtojca 15: Kushtet e Përgjithshme të Kontratës
- Shtojca 16: Kushtet e Vecanta të Kontratës
- Shtojca 17: Formulari i Sigurimit të Kontratës



Kushtet e Përgjithshme të Kontratës (KPK)

Këto Kushte të Përgjithshme të Kontratës (KPK), së bashku me Kushtet e Veçanta dhe dokumentet e tjera të renditura në to, përbëjnë një dokument të plotë që shpreh të drejtat dhe detyrimet e palëve.

Neni 1 Dispozitat e përgjithshme**1.1 Përkufizimet**

Në Kushtet e Kontratës ("këto Kushte"), të cilat përfshijnë Kushtet e Veçanta dhe këto Kushte të Përgjithshme, fjalët dhe shprehjet e mëposhtme kanë këto kuptime:


1.1.1 Kontrata

- 1.1.1.1** "Kontrata" do të thotë kontrata me shpërblim, e lidhur me shkrim, ndërmjet një apo më shumë operatorëve ekonomikë dhe një ose më shumë autoriteteve ose enteve kontraktore, që kanë si objekt kryerjen e punimeve, furnizimin e mallrave dhe shërbimeve, në përputhje me LPP.
- 1.1.1.2** "Dokumentet e Kontratës" do të thotë dokumentet e renditura në Kontratë, përfshirë çdo ndryshim të saj.
- 1.1.1.3** "Çmimi i Kontratës" do të thotë çmimi që i paguhet Furnizuesit siç specifikohet në kontratë.
- 1.1.1.4** "Përfundimi" do të thotë përmbushja e të gjitha detyrimeve, me ose pa penalitet, nga Furnizuesi në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara në Kontratë.
- 1.1.1.5** "Ndërprerje e Kontratës" do të thotë mosvijimi i ekzekutimit të Kontratës sipas përcaktimeve në Nenin 23.
- 1.1.1.6** "Specifikime teknike" do të thotë karakteristikat e Shërbimeve objekt kontrate dhe çdo shtesë dhe modifikim i këtyre karakteristikave në përputhje me Kontratën.
- 1.1.1.7** "Termet e Referencës" shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.
- 1.1.1.8** "Listat" do të thotë dokumenti (et) me titull Listat të plotësuara nga Furnizuesi dhe të dorëzuara me ofertën, siç janë të përfshira në Kontratë. Dokumente të tilla mund të përfshijnë Listat e Çmimeve të dhëna, Listat e tarifave dhe / ose çmimeve.
- 1.1.1.9** "Ofertë" do të thotë oferta ekonomike dhe të gjitha dokumentet e tjera që Furnizuesi ka dorëzuar me ofertën ekonomike, siç janë përfshirë në Kontratë.
- 1.1.1.10** "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.
- 1.1.1.11** "KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

1.1.2 Palët e Kontratës

1.1.2.1 "Palë" do të thotë nënshkruarit e kontratës, në cilësinë e Blerësit dhe Furnizuesit sipas kontekstit.

1.1.2.2 "Blerës" do të thotë Autoriteti/Enti Kontraktor përfituesi i Shërbimeve objekt kontrate.



1.1.2.3 "Furnizues" do të thotë operatori (ët) ekonomik që kryen furnizimine Shërbimeve objekt kontrate.

1.1.2.4 "Nënkontraktor" do të thotë çdo subjekt i caktuar si nënkontraktor për kryerjen e një pjese të Shërbimeve.

1.1.3 Llogaritja e afateve

1.1.3.1 "Ditë" do të thotë një ditë kalendarike.

1.1.4 Shërbimet

1.1.4.1 "Shërbime" do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Furnizuesi sipas Kontratës.

1.1.5 Përkufizime të tjera

1.1.5.1 "Adresa e Blerësit" është adresa e specifikuar në KVK.

1.1.5.2 "Forca Madhore" është përcaktuar në Nenin 20 "Forca Madhore".

1.1.5.3 "Sigurimi i Kontratës" është sipas përcaktimeve të Nenit 11 "Sigurimi i Kontratës".

1.1.5.4 "Vendi i kryerjes së Shërbimeve", do të thotë vendi i përcaktuar në KVK.

1.1.5.5 "E paparashikueshme" ose "E paparashikuar" do të thotë një ngjarje objektivist e pamundur të parashikohet në momentin e publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE.

1.1.5.6 Modifikimi i kontratës" është sipas përcaktimeve në Nenin 21.

1.1.5.7 "Legjislacioni në fushën e prokurimit" do të thotë LPP-ja, Rregullat e Prokurimit Publik dhe akte të tjera nënligjore në bazë dhe për zbatim të LPP –së siç specifikohet në KVK.

1.1.5.8 "Praktikat e Ndaluar" kanë kuptimin e përcaktuar në LPP.

1.2 Interpretimi

1.2.1 Interpretimi i Kontratës, përveç kur konteksti kërkon ndryshe:

(a) fjalët që tregojnë një gjini përfshijnë të gjitha gjinitë;

(b) fjalët që tregojnë njëjës përfshijnë edhe shumësin dhe fjalët që tregojnë shumësin përfshijnë edhe njëjës;

(c) dispozitat që përfshijnë fjalën "bie dakord", "rënë dakord" ose "marrëveshje" kërkojnë që marrëveshja të dokumentohet me shkrim;


(d) "i shkruar" ose "me shkrim" do të thotë i shkruar me dorë, i shkruar me makinë, printuar ose i bërë në mënyrë elektronike.

1.2.2 Modifikimi

Çdo modifikim i Kontratës i cili nuk kryhet me shkrim, dhe nuk përmban datën, apo nuk i referohet shprehimisht Kontratës dhe nuk nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar rregullisht i secilës Palë është i pavlefshëm. Palët nuk mund të bëjnë modifikime të asnjë elementi të kontratës që do të sillnin ndryshime thelbësore në kushtet mbi bazën e të cilave është përzgjedhur Furnizuesi.

1.2.3 Heqja dorë

Çdo heqje dorë nga të drejtat, kompetencat ose mjetet ligjore të një Pale sipas Kontratës duhet të bëhet me shkrim, me datë dhe e nënshkruar nga një përfaqësues i autorizuar i Palës që bën këtë dorëheqje, dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe



masën nga e cila po hiqet dorë.

1.2.4 Ndikimi i pavarur i dispozitave të kontratës

Nëse ndonjë dispozitë ose kusht i Kontratës është i ndaluar ose bëhet i pavlefshëm ose i pazbatueshëm, një ndalim, pavlefshmëri apo pazbatueshmëri e tillë nuk ndikon në vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e ndonjë dispozite dhe kushti tjetër të Kontratës.

1.3 Komunikimet

Kurdo këto Kushte parashikojnë dhënien ose lëshimin e miratimeve, certifikatave, pëlqimeve, përcaktimeve, njoftimeve, kërkesave dhe shlyerjeve këto komunikime do të jenë:

(a) me shkrim dhe të dorëzuara dorazi (kundrejt marrjes), dërguar me postë ose korrier, ose transmetuar duke përdorur ndonjë nga sistemet e rena dakord të transmetimit elektronik siç përshkruhet në KVK;

Dhe

(b) dorëzuar, dërguar ose transmetuar në adresën për komunikimet e marrësit siç përshkruhet në KVK. Sidoqoftë:

(i) nëse marrësi njofton një adresë tjetër, komunikimet do të dorëzohen në përputhje me rrethanat; dhe

(ii) nëse marrësi nuk ka deklaruar ndryshe kur kërkon një miratim ose pëlqim, mund të dërgohet në adresën nga e cila është lëshuar kërkesa.

Miratimet, pëlqimet dhe përcaktimet nuk do të mbahen ose vonohen pa arsye.

1.4 Ligji dhe gjuha

Kontrata do të rregullohet dhe interpretohet sipas legjislacionit Shqiptar në fuqi.

Gjuha e Kontratës do të jetë ajo e deklaruar në KVK.

Gjuha për komunikime do të jetë ajo e deklaruar në KVK. Nëse aty nuk përcaktohet asnjë gjuhë, gjuha për komunikime do të jetë gjuha e përcaktuar e Kontratës.

Dokumentet mbështetëse dhe literatura e shtypur që janë pjesë e Kontratës mund të jenë në një gjuhë tjetër me kusht që ato të shoqërohen nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse dhe, për qëllime të interpretimit të Kontratës, ky përkthim do të mbizotërojë.

Furnizuesi do të përballojë të gjitha kostot e përkthimit dhe të gjitha risqet e saktësisë së një përkthimi të tillë, për dokumentet e siguruar nga Furnizuesi.

1.5 Prioriteti i Dokumenteve

Dokumentet që formojnë Kontratën duhet të konsiderohen reciprokisht shpjeguese të njëri-tjetrit. Nëse në dokumente gjendet një paqartësi ose mospërputhje, Blerësi lëshon çdo sqarim ose udhëzim të nevojshëm.

1.6 Hartimi i Kontratës

1.6.1 Njoftimi i ofertës fituese në përfundim të afateve të ankimit do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.

1.6.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës.



1.7 E drejta e autorit

- 1.7.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, e drejta e autorit në të gjitha dokumentet dhe materialet e tjera që përmbajnë të dhëna dhe informacione të dhëna Blerësit nga Furnizuesi këtu do t'i mbeten Blerësit, edhe nëse ato i janë furnizuar Blerësit drejtpërdrejt ose përmes Furnizuesit nga ndonjë pale të tretë, përfshirë furnizuesit e materialeve.

1.8 Detaje Konfidenciale

Furnizuesi dhe personeli i Blerësit do të zbulojnë çdo informacion të tillë konfidencial dhe informacione të tjera që mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme për të verifikuar pajtueshmërinë e Furnizuesit me Kontratën dhe për të lejuar zbatimin e duhur të saj.

Secili prej tyre do t'i trajtojë të dhënat e kontratës në mënyrë konfidenciale, deri në masën e nevojshme për të kryer detyrimet e tyre përkatëse sipas Kontratës ose për të qenë në përputhje me ligjet në fuqi. Asnjë prej tyre nuk do të publikojë ose zbulojë të dhëna të veçanta të Shërbimeve të përgatitura nga Pala tjetër pa marrëveshjen paraprake të Palës tjetër. Sidoqoftë, Furnizuesit lejohen të zbulojnë çdo informacion publikisht të disponueshëm, ose informacion që kërkohet për të provuar kualifikimet e tij për të konkurruar në procedura të tjera.

Pavarësisht nga sa më sipër, Furnizuesi mund t'i sigurojë Nënkontraktorit (eve) të tij dokumente, të dhëna dhe informacione të tjera që merr nga Blerësi në masën e kërkuar që Nënkontraktori (ët) të kryejë punën e tij sipas Kontratës. Në rast të tillë, Furnizuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me Nënkontraktorin/ët një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit sikurse parashikohet në adresë të Furnizuesit sipas këtij neni.

1.9 Pajtueshmëria me ligjet

Gjatë realizimit të Kontratës Furnizuesi respekton ligjet në fuqi.

Nëse nuk përcaktohet ndryshe në Kushtet e Veçanta:

(a) Blerësi siguron dhe paguan të gjitha lejet, miratimet dhe / ose licencat nga të gjitha autoritetet lokale, shtetërore ose kombëtare ose ndërmarrjet e shërbimeve publike në vendin e Blerësit që (i) autoritete ose ndërmarrje të tilla i kërkojnë Blerësit të sigurojë në emër të tij dhe (ii) janë të domosdoshëm për ekzekutimin e Kontratës, përfshirë ato që kërkohen për përmbushjen e detyrimeve përkatëse si nga Furnizuesi ashtu dhe Blerësi sipas Kontratës;

(b) Furnizuesi siguron dhe paguan të gjitha lejet, miratimet dhe / ose licencat nga të gjitha autoritetet lokale, shtetërore ose kombëtare ose ndërmarrjet e shërbimeve publike në vendin e Blerësit që autoritete ose ndërmarrje të tilla i kërkojnë Furnizuesit të sigurojë në emër të tij dhe që janë të nevojshme për kryerjen e Kontratës, duke përfshirë, pa u kufizuar, vizat për personelin e Furnizuesit dhe Nënkontraktorit dhe lejet e hyrjes për të gjitha pajisjet e importuara të Furnizuesit. Furnizuesi siguron të gjitha lejet, miratimet dhe / ose licencat e tjera që nuk janë përgjegjësi e Blerësit sipas pikës (a) të këtij neni këtu dhe që janë të nevojshme për ekzekutimin e Kontratës. Furnizuesi do të dëmshpërblejë dhe zhdëmtojë Blerësin nga dhe kundër çdo dhe të gjitha detyrimeve, dëmeve, pretendimeve, gjobave, penaliteteve dhe shpenzimeve të çfarëdo natyre që lindin ose rezultojnë nga shkelja e ligjeve të tilla nga Furnizuesi ose personeli i tij, duke përfshirë

Nënkontraktorët dhe personelin e tyre, por pa cënuar Nenin 9.1.

1.10 Përgjegjësia e përbashkët dhe solidare

Nëse Furnizuesi është një bashkim i Operatorëve Ekonomikë, të gjithë këta Operatorë Ekonomikë do të jenë bashkërisht dhe solidarisht përgjegjës ndaj Blerësit për përmbushjen e dispozitave të Kontratës.

1.11 Inspektimet dhe Auditimi nga Blerësi

Furnizuesi i përgjigjet pyetjeve dhe i jep Blerësit çdo informacion ose dokument të nevojshëm për (i) hetimin e pretendimeve të Praktikave të Ndaluar, ose (ii) monitorimin dhe vlerësimin nga ana e Blerësit të Kontratës dhe për t'i dhënë mundësi Blerësit të shqyrtojë dhe adresojë çdo problematikë në lidhje me Kontratën.

Furnizuesi mban të gjithë dokumentacionin në lidhje me zbatimin e Kontratës në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 2 Praktikave të Ndaluar

2.1 Furnizuesi nuk do të autorizojë ose lejojë asnjë nga punonjësit ose përfaqësuesit e tij, të angazhohen në Praktika të Ndaluar në lidhje me prokurimin, dhënien ose ekzekutimin e Kontratës.

2.2

Nëse Blerësi konstaton se dhënia e kontratës është bërë në kushtet e konfliktit të interesit dhe ky fakt nuk ka qenë i mundur të identifikohet më parë, i kërkon Komisionit të Prokurimit Publik të deklarojë kontratën absolutisht të pavlefshme.

Nëse Blerësi gjatë zbatimit të kontratës ka informacion për veprime korruptive informon organet kompetente.

Neni 3 Njoftimet

3.1 Çdo njoftim i dhënë nga njëra Palë tek tjetra, në përputhje me Kontratën, do të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në KVK.

3.2 Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

Neni 4 Objekti i Furnizimit

4.1 Shërbimet që do të furnizohen duhet të jenë sipas termave të referencës dhe kushteve të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit.


4.2 Kushtet e kontratës nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese, me përjashtim të rasteve kur Furnizuesi, për arsye objektive dhe të pavarura prej tij në kohën e ofertimit ofron, me të njëjtin çmim, kushte më të mira se ato të tenderuara.

Neni 5 Dorëzimi

5.1 Dorëzimi i Shërbimeve do të jetë në përputhje me kërkesat e specifikuar në Dokumentet e Tenderit.

Neni 6 Përgjegjësitë e Furnizuesit

6.1 Furnizuesi do të jetë përgjegjës për kryerjen e të gjitha Shërbimeve në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Dokumentet e Tenderit.



Neni 7 Detyrimet e Përgjithshme të Furnizuesit

- 7.1 Furnizuesi duhet t'i kryejë Shërbimet dhe përmbushë detyrimet e tij me të gjitha përpjekjet, eficiente dhe ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale të pranuar në përgjithësi.
- 7.2 Furnizuesi duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigurta.
- 7.3 Nëse kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Furnizuesi duhet të veprojë gjithmonë si një këshillues besnik i Blerësit, në pajtim me rregullat dhe kodin e sjelljes të profesionit të tij dhe duhet që të mbështesë dhe ruajë gjithmonë interesin publik.
- 7.4 Nëse kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Furnizuesi duhet të ushtrojë kujdes të plotë në marrëdhëniet me palët e treta duke përfshirë median dhe nuk duhet të marrë pjesë në veprime që janë jashtë kompetencës së tij në përfaqësimin e Blerësit.

Neni 8 Detyrimet e Veçanta të Furnizuesit

- 8.1 Furnizuesi duhet të kryejë të gjitha Shërbimet siç specifikohet tek Termat e Referencës.
- 8.2 Furnizuesi duhet t'i paraqesë Blerësit të gjitha shërbimet, në sasi të përcaktuara, siç kërkohen nga kontrata duke përfshirë, por jo të kufizuara nga, të gjitha raportet, dokumentat, studimet, skicimet dhe planimetritë.
- 8.3 Furnizuesi duhet të sigurojë raportet e lidhura me zbatimin e Shërbimeve siç kërkohet në kontratë.

Neni 9 Çmimi i Kontratës

- 9.1 Çmimi i kontratës do të jetë i pandryshueshëm përgjatë kohëzgjatjes së realizimit të Kontratës, përveç rasteve të parashikuara në Nenin 19.

Neni 10 Kushtet e Pagesës

- 10.1 Çmimi i Kontratës do të paguhet siç specifikohet në KVK.
Furnizuesi duhet të paguhet nga Blerësi për Shërbimet e kryera, në përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në Kontratë.
- 10.2 Pagesat do të kryhen menjëherë nga Blerësi, jo më vonë se periudha kohore e specifikuar në KVK pas dorëzimit të një fature ose kërkesë për pagesë nga Furnizuesi, dhe pasi Blerësi ta ketë pranuar atë.
- 10.3 Nëse nuk përcaktohet ndryshe në KVK, pagesa duhet bërë në monedhë Shqiptare. Kursi i këmbimit të monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankës së Shqipërisë i fiksuar në ditën e dërgimit për publikim të njoftimit të kontratës.
- 10.4 Në rast të verifikimit të vonësave në kryerjen e pagesave nga ana e Blerësit, megjithëse Furnizuesi ka përmbushur të gjitha detyrimet e tij në përputhje me kushtet e kontratës, detyrimet e prapambetura dhe kamatëvonesat përkatëse do të kryhen në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare".



Kushtet e Veçanta të Kontratës

Kushtet e mëposhtme të veçanta të Kontratës do të plotësojnë KPK. Nëse ka një konflikt, dispozitat e KVK do të mbizotërojnë mbi ato në KPK.

Neni 1 Dispozitat e Përgjithshme**1.1** Blerësi është: *[Këshilli i Lartë Gjyqësor]*

Adresa: Rruga ‘Ana Komnena’, Godina Poli i Drejtësisë, Tiranë

E-mail: kontakt@klgj.al

1.2 Furnizuesi është: *[PC STORE]*

Adresa: Rruga e Dibrës, vila 153, kati 1, 1001, Tiranë, Shqipëri

Telefoni: 0682017554/ 042221076

E-mail: info@pcstore.al

Të dhënat e mësipërme duhet të jenë të sakta për qëllime të komunikimeve gjatë zbatimit të kontratës.

1.3 Gjuha për komunikimet është *[SHQIP]:*

Gjuha është: *[SHQIP]*

Neni 2 Sigurimi i Kontratës

2.1 Sigurimi i Kontratës në shumën prej (10% të 110.956.584,24) duhet të ofrohet nga Furnizuesi për të siguruar ekzekutimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

2.2 Monedha do të jetë: *[LEKË]*

2.3 Sigurimi i Kontratës do t'i lëshohet ose kthehet, menjëherë Furnizuesit sipas formularit të mëposhtëm

2.4 Nëse parashikohet një ulje periodike e sigurimit të Kontratës, ajo kryhet si më poshtë: *Nëse nuk plotësohet, sigurimi mbetet i pandryshuar.*

Neni 3 Vendndodhja e Shërbimeve

3.1 Shërbimet do të kryhen në:

NR.

Gjykata

- | | |
|---|----------------------------------|
| 1 | Gj. Admin. Shk. Parë Durrës |
| 2 | Gj. Admin. Shk. Parë Gjirokastrë |
| 3 | Gj. Admin. Shk. Parë Korçë |
| 4 | Gj. Admin. Shk. Parë Shkodër |
| 5 | Gj. Admin. Shk. Parë Tiranë |

- 6 Gj. Admin. Shk. Parë Vlorë
- 7 Gj. Admin. e Apelit Tiranë
- 8 Gj. e Apelit Durrës
- 9 Gj. e Apelit Gjirokastrë
- 10 Gj. e Apelit Korçë
- 11 Gj. e Apelit Shkodër
- 12 Gj. e Apelit Tiranë
- 13 Gj. e Apelit Vlorë
- 14 Gj. e Rrethit Gjyqësor Berat
- 15 Gj. e Rrethit Gjyqësor Dibër
- 16 Gj. e Rrethit Gjyqësor Durrës
- 17 Gj. e Rrethit Gjyqësor Elbasan
- 18 Gj. e Rrethit Gjyqësor Fier
- 19 Gj. e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë
- 20 Gj. e Rrethit Gjyqësor Kavajë
- 21 Gj. e Rrethit Gjyqësor Korçë
- 22 Gj. e Rrethit Gjyqësor Krujë
- 23 Gj. e Rrethit Gjyqësor Kukës
- 24 Gj. e Rrethit Gjyqësor Kurbin
- 25 Gj. e Rrethit Gjyqësor Lezhë
- 26 Gj. e Rrethit Gjyqësor Lushnjë
- 27 Gj. e Rrethit Gjyqësor Mat
- 28 Gj. e Rrethit Gjyqësor Përmet
- 29 Gj. e Rrethit Gjyqësor Pogradec
- 30 Gj. e Rrethit Gjyqësor Pukë
- 31 Gj. e Rrethit Gjyqësor Sarandë
- 32 Gj. e Rrethit Gjyqësor Shkodër
- 33 Gj. e Rrethit Gjyqësor Tiranë
- 34 Gj. e Rrethit Gjyqësor Tropojë
- 35 Gj. e Rrethit Gjyqësor Vlorë
- 36 Gj. e P.KKO
- 37 Gj. P.A.K.K. O
- 38 Gj. e Lartë

Neni 4 Informacion që duhet dhënë nga Blerësi

- 4.1 Brenda 15 ditësh nga marrja e sigurimit të kontratës, Blerësi duhet t'i japë Furnizuesit informacionin dhe dokumentat e mëposhtme:

Neni 5 Kërkesat e Raportimit

- 5.1 Gjatë zbatimit të kontratës, Furnizuesi duhet të sigurojë raporte për Blerësin sipas formularit të mëposhtëm:

Faza e I - Perpilimi dhe dorezimi i raportit të analizës së biznesit nëpërmjet:

- Intervistimin e të gjithë kategorive të perdoruesve që mendohet të

përdorin sistemin,

- Analizimin e bazës ligjore dhe të rregulloreve që disponon AK.
- Analizes se standardeve nderkombetare te arkivimit.
- Perpilimin dhe dorezimin e raportit te analizes se biznesit tek AK.
- Marrja e aprovimit të raportit të Analizës së Biznesit nga AK.

Kërkesat e Raportimin

Kontraktuesi do të paraqesë raportet e mëposhtme në <gjuhën> në origjinal dhe <numër (për arsye mjedisore, kërkohet sa më pak kopje të letrës të jetë e mundur)> kopje:

- **Raporti Fillestar** prej maksimumi 20 faqesh duhet të prodhohet pas 1 muaji, nga fillimi i implementimit. Në raport Kontraktuesi duhet të përshkruaj p.sh. gjetjet fillestare, progresi në mbledhjen e të dhënave, çdo vështirësi të pritura ose të hasura përveç programit të punës apo udhëtimeve të stafit. Kontraktuesi duhet të vazhdojë me punën e tij / saj derisa Autoriteti Kontraktues të dërgoj komente mbi raportin fillestar.
- **Drafti i raportit përfundimtar** duhet te perbehet prej 30 faqesh (teksti kryesor, duke përjashtuar anekset). Ky raport duhet të dorëzohet jo më vonë se 1 muaj para përfundimit të periudhës së zbatimit të detyrave.
- **Raporti final** me të njejtat specifika si drafti i raportit përfundimtar, inkorporimin e komenteve të pranuar nga palët në draft raport. Afati i fundit për dërgimin e raportit përfundimtar është 20(njëzet) ditë pas marrjes së komenteve në draft raportin përfundimtar. Raporti duhet të përmbajë një përshkrim mjaftueshëm të detajuar të opsioneve të ndryshme per te mbeshtetur nje vendim te informuar mbi sistemet e implementuara. Analizat e detajuara që i mbështesin rekomandimet do të prezantohen në anekset në raportin kryesor. Raporti përfundimtar duhet të sigurohet së bashku me faturën përkatëse.

Dorëzimi dhe miratimi i raporteve

Raporti i përmendur më sipër duhet t'i dorëzohet grupit të punës/nëpunësi i ngarkuar për ndjekjen e zbatimit të kontratës të identifikuar në kontratë.

Grupi i punës/nëpunësi i ngarkuar për ndjekjen e zbatimit të kontratës është përgjegjës për aprovimin e raporteve.

Grupi i punës duhet të realizojë aprovimin e raporteve të mësipërme apo çdo raport tjetër të ndërmjetëm që mund të kërkohet gjatë projektit brenda një afati 5 ditor nga marrja e raportit. Nëse nuk zbatohen këto afate në kohë, atëherë raporti quhet i aprovuar automatikisht dhe vijohet me proceset e radhës.

5.2

Kontraktori duhet të sigurojë me kamera ambientet fizike gjatë gjithë procesit të zbatimit të kontratës.

Dokumentacioni me pamjet filmike origjinale do i dorëzohet Grupit të Punës së bashku me Raportet e zbatimit të kontratës.



Neni 6 Siguracioni i Përgjegjësisë Profesionale

- 6.1 Përpara fillimit të zbatimit të kontratës, Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin/entin Kontraktor me prova për siguracionin e përgjegjësisë profesionale si vijon:

Administratori i Kontraktorit duhet të depozitojë Deklaratën e Konfidencialitetit.

Çdo punonjës i përfshirë në procesin e zbatimit të kontratës, përpara fillimit të zbatimit të kontratës duhet të depozitojnë Deklaratat e Konfidencialitetit.

Rregulla më të detajuara do të dakortësohen në Formularin e Zbatimit të Kontratës.

Neni 7 Çmimi i Kontratës

Çmimi i Kontratës është: 92.463.820,20 (nëntëdhjetë e dy milion e katërqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e tetëqind e njëzet, 20) lekë pa tvsh dhe 110.956.584,24 (njëqind e dhjetë milion e nëntëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e katër presje 24) lekë me tvsh deri në 31.12.2024.

Neni 8 Kushtet e pagesës

- 8.1 (a) Pagesa për Shërbimet do të bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e pranimit të Shërbimeve ose nga data e marrjes së kërkesës për pagesë me shkrim, pavarësisht nga dita e ardhjes. Nëse nuk specifikohet, periudha kohore do të jetë 30 ditë.

(b) Pagesa do të bëhet në monedhën lekë . Nëse lihet e paplotësuar, pagesa do të bëhet në monedhën Shqiptare.

- 8.2 Të gjitha pagesat e shumave që i detyrohen Furnizuesit mund të bëhen vetëm në llogarinë bankare të Furnizuesit të detajuar në mënyrë të qartë në Kontratë.

NR LLOG _____

Neni 9 Garancia

- 9.1 Periudha e vlefshmërisë së garancisë do të jetë si më poshtë:

Garancia për sistemin do të jete 3 vjet duke nisur nga pranimi i sistemit

Grancia për Server i Bazes se te dhenave 3 vjet

Grancia për Server për Aplikacion 3 vjet

Grancia për Storage 3 vjet

Grancia për Skaner Model 1 është 3 vjet

Grancia për Skaner Model 2 është 3 vjet

Neni 10 Sanksione

10.1 Në rast të mos realizimit të kushteve të përcaktuara në DST, në ofertën e paraqitur nga ofertuesi si dhe në kushtet e përcaktuara në këtë kontratë, në rast të vonesave në fillimin e realizimit të kontratës kontraktuesi i shërbimit detyrohet të paguaje penaltetin për çdo vonesë sipas përcaktimeve në Formularin e Zbatimit të Kontratës.

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS + SPECIFIKIMET TEKNIKE
PËRMBAJTJA

<u>Aneksi 1 – TERMA REFERENCE PER PROJEKTET TIK</u> .. Error! Bookmark not defined.	
<u>FAQJA E KONTROLLIT TË DOKUMENTIT</u>	Error! Bookmark not defined.
<u>Historiku i Versioneve dhe Ndryshimeve të Dokumentit</u>	Error! Bookmark not defined.
<u>PËRMBAJTJA</u>	14
<u>1.HYRJE</u>	15
<u>1.1.Përfituesi /Autoriteti Kontraktues</u>	15
<u>1.2.Historiku</u>	15
<u>1.3Situata Aktuale</u>	15
<u>2. OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA</u>	16
<u>2.1.Objektivi i Përgjithshëm</u>	16
<u>2.2.Qëllimi</u>	16
<u>2.3.Rezultatet që duhet të arrihen nga Kontraktori</u>	17
<u>3.SUPOZIMET DHE RISQET</u>	17
<u>3.1.Supozimet e Projektit</u>	17
<u>3.2.Risqet</u>	17
<u>4.QËLLIMI I PUNËS</u>	18
<u>4.1.Të Përgjithshme</u>	18
<u>4.2.Hapësira gjeografike që do të mbulohet</u>	18
<u>4.3.Grupet e synuara</u>	18
<u>4.4.Siguria e sistemit</u>	19
<u>4.5.Detyrat specifike</u>	19
<u>5.LOGJISTIKA DHE KOHA</u>	21
<u>5.1.Vendndodhja</u>	21
<u>5.2.Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave</u>	21
<u>6.RAPORTIMI</u>	21
<u>6.1.Kërkesat e Raportimin</u>	12
<u>6.2.Dorëzimi dhe miratimi i raporteve</u>	12
<u>7.KOMUNIKIMI ME SISTEME TË TJERA</u>	22
<u>8.GARANCIA</u>	22
<u>9.MIRËMBAJTJA</u>	22
<u>10.DOKUMENTACIONI QË TI PËRSHIHET DIGJITALIZIMIT</u>	25
<u>Volumi i kodekseve (volumet e vendimeve gjyqësore) që administrohen aktualisht nga gjykatat</u>	25
<u>Volumi i regjistrave që administrohen aktualisht nga gjykatat</u>	26
<u>Volumi i numërorëve që administrohen aktualisht nga gjykatat</u>	27
<u>Volumi i dokumentacionit që administrohen aktualisht nga gjykatat</u>	28
<u>11.PLANIFIKIMI I BUXHETIT PËR NDËRTIMIN E SISTEMIT</u>	30
<u>12.AFATI KOHOR I IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT</u> ... Error! Bookmark not defined.	
<u>13.TË DREJTAT E KODIT TË APLIKACIONIT</u>	31
<u>Duhet të përshtaten dhe krijohen fushat e indeksuara sipas:</u>	31
<u>Të dhëna për dokumentat:</u>	31
<u>i.Nr. Dokumenti</u>	31
<u>ii.Datë Dokumenti</u>	31
<u>iii.Emërtimi</u>	31
<u>iv.Nr. Faqesh</u>	31
<u>v.Nr. Protokolli (për dokumentat e ardhura dhe për dokumentat e gjeneruara nga institucioni)</u>	31
<u>vi.Datë Protokolli</u>	31

vii. Komentet	31
Klasifikimi i dokumentave	32
Përgatitja e dokumentave për skanim:	32
Skanimi i dokumentave	33
Elementet e cilesisë të imazhit arkivor (Skedari Bazë)	33
Tonaliteti	33
Rezolucioni	34
•Skedari Bazë	34
Funksionalitete	36
Manaxhim Proçesesh (Business Process Management)	40
Panelet Informative (Dashboards)	40
13. Raportet	40
14 KËRKESAT TEKNIKE	41
14.1 Komponente Hardware	41
Server i Bazes se te dhenave	13
Server për Aplikacion	13
Skaner Model 1	13
SkanerModel 2	16

1. HYRJE

1.1. Përfituesi /Autoriteti Kontraktues

Përfituesi / Keshilli i Larte Gjyqesor

1.2. Historiku

Këshilli i Lartë Gjyqësor në kuadër të dixhitalizimit është duke ndërmarrë një reformë rrënjësore në mënyrën e ofrimit të shërbimeve për publikun, biznesin si dhe vetë administratën. Gjithmonë e më shumë, në ndihmë të ofrimit të shërbimeve, po vjen Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit. Shumë nga proceset që deri dje bëheshin në mënyrë manuale, sot janë automatizuar. Kjo do të thotë se për disa shërbime të caktuara do të duhet të konsultohen regjistrat në mënyrë manuale, çka do të çonte në vonesa në ofrimin e këtyre shërbimeve.

Situata Aktuale

Keshilli i Larte Gjyqesor është përfituesi i projektit. Volumi dhe puna e kërkuar nuk mund të mbulohet nga vetë institucioni, veçanërisht kur përfundimi i tyre kërkohet brenda një kohe relativisht të shkurtër.

Përqindja e realizimit të dixhitalizimit të regjistrave për këtë institucion aktualisht është: 0%

Aktet e arkivuara rezultojnë të jenë të natyrave dhe llojeve të ndryshme. Ato përbëhen nga dosje gjyqësore të qepura në forma të ndryshme në varësi të gjykatave. Në disa gjykata qepja realizohet me spango dhe në gjykata të tjera në formën e dosjeve të lidhura me kapëse metalike.

Gjithashtu në dosjet gjyqësore penale përfshihet fashikulli hetimor, material i krijuar nga prokuroria përkatëse të cilat gjithashtu janë të qepura (kapura) më vete në mënyra të ndryshme.



Pjesë e fondit arkivor të gjykatave janë edhe kodekset të cilët përbëjnë totalitetin e vendimeve gjyqësore të prodhuara nga gjykata. Material tjetër janë regjistrat të cilët në varësi të gjykatës janë në format A4 dhe A3.

Pjesë e dokumentacionit arkivor janë aktet administrative të prodhuara nga gjykata për efekt të veprimtarisë së saj jo gjyqësore si për shembull akte të titullarit, akte mbi veprimtarinë financiare dhe të burimeve njerëzore etj.

Sa i përket vjetërsisë së dokumenteve evidentohet se ruhen akte që prej 1945 pasi në asnjë nga gjykatat nuk është zhvilluar procesi i rregullimit të arkivës dhe asgjësimit të akteve të cilat kanë kaluar afatin e ruajtjes.

I gjithë fondi arkivor është i pa digjitalizuar dhe gjendet në formë shkresore në ambientet e gjykatës. Arkivat e gjykatave nuk janë në ambiente të qendëruara në çdo gjykatë, por janë të shpërndara në ambiente të ndryshme duke filluar nga arkivi, kryesekretaria dhe zyra e kryetarit të gjykatës.

Për shkak të mosqendërimit të arkivës, dhe mungesës së hapësirave ndërtimore gjykatat nuk kanë një arkivë të mirfilltë dhe standarde infrastrukturore për ruajtjen e materialeve shkresore. Në arkivat e gjykatave evidentohet mungesa e sistemit të sigurisë së ambjenteve dhe për pasojë mungesa e sigurisë së ruajtjes së arkivës nga raste fatore apo me dashje pasi në ambientet ku ruhen dosjet nuk janë të instaluar sisteme kundër zjarri, alarmet kundër zjarrit, mjetet për shuarjen e zjarreve të mundshme etj).

2. OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA

2.1. Objektivi i Përgjithshëm

Objektivi i përgjithshëm i projektit nga i cili kjo kontratë do të jetë skanimi i fondit arkivor të gjykatave të Republikës së Shqipërisë, skanimet e kryera të ruhen në format digjital në pajisje të pershtatshme për ruajtjen, kerkimin dhe përdorimin e tyre në të ardhmen, implementimi i një sistemi të bazuar mbi platforme low-code/no-code dhe arkivimin digjital të dokumenteve të Gjykatave të cilat ruhen në arkivin e seciles gjykate, sipas specifikimeve teknike dhe kërkesave funksionale të parashikuara në këtë dokument.

2.2. Qëllimi

Qëllimi(et) i kësaj kontrate është/janë si më poshtë:

- Skanimi i dokumentacionit:
 - kodeksat (volumet e vendimeve gjyqësore), për çështjet penale, civile dhe administrative;
 - regjistrat themeltarë të çështjeve gjyqësore;
 - numratorët e vendimeve;
 - dokumenta administrative (Urdhëra të titullarit, Vendime të Këshillit të Gjykatës etj)
- Implementimi i një sistemi informatik(programi kompjuterik) i cili do të shërbejë për administrimin e arkives digjitale dhe aplikimi i proceseve të punës që lidhen me aktivitetet kryesore të arkives digjitale me qëllim ofrimin e lehtësimit në procedurat e administrimit të dosjeve, në kerkim e përpunimin e dokumenteve arkivore.
- Sistemi që do të implementohet duhet të jetë i bazuar në standardet të përgjithshme ndërkombetare për arkivim.



- Informatizimin e proceseve kryesore te punes se punonjesve qe jane te angazhuar ne procese pune qe lidhen direkt me dokumentet e arkives.
- Shtimi i ketyre fushave si element kerkimi dhe si te dhene paresore per bazen e te dhenave;
- Lehtësimin ne menaxhim dhe ne mirembajtje teknike;
- Hedhjen dhe ruajtjen e materialeve digjitale te formateve te ndryshme dhe mundësinë e aksesit të tyre ne nderfaqen e perdoruesit sipas të roleve dhe të drejtave të tyre.
- Ofrimi i shërbimit apo funksionimi i sistemit pa nderprerje ne ditet e punes

Sistemi që do të ndërtohet dhe zbatohet, duhet të jetë në përputhje me dispozitat e vendimit nr. 945, datë 02.11.2012, Për miratimin e rregullores “Administrimi i sistemit të Bazave të të Dhënave Shtetërore”, në lidhje me disponueshmërinë, integritetin dhe konfidencialitetin e sistemit.

2.3. Rezultatet që duhet të arrihen nga Kontraktori

Në përfundim të projektit operatori ekonomik fitues duhet te kete permbushur detyrat e listuara ne vijim:

- Skanimi i dokumentacioneve te arkives se cdo gjykate .
- Indeksimi i dokumentacionit.
- Instalimi dhe konfigurimi i sistemit të arkivimit digjital sipas specifikimeve teknike dhe funksionaliteteve te kerkuara, dhe në përputhje me legjislacionin ne fuqi, standardet kombëtare dhe nderkombetare te kerkuara. Sistemi i arkivit digjital duhet të implementohet në përputhje me workflow apo rrjedhën e punës së proceseve të punës së Autoritetit Kontraktor(AK).
- Të ketë testuar dhe korrigjuar te gjitha gabimet e dala gjatë fazes se testimit.
- Trajnimi i perdoruesve të të gjithë niveleve
- Dorëzim i dokumenteve dhe manualeve teknike dhe manualeve të perdorimit në gjuhën shqipe.
- Implementimi i sistemit te arkives digjitale 2 muaj nga nenshkrimi i konktrates
- Mirëmbajtjen e sistemit për një periudhë prej 3(tre) vjeçare.

3. SUPOZIMET DHE RISQET

3.1. Supozimet e Projektit

Faktorët që supozohet se mund të kenë ndikim në ecurinë e projektit, janë të përshkruara si më poshtë

- Niveli i angazhimit dhe mbeshtetjes së plotë të të gjithë aktoret te perfshire ne kete projekt.
- Analiza e plote dhe e saktë e të gjithë proceseve të punës dhe roli i çdo perdoruesi ne çdo hap;
- Përcaktimi i saktë i te drejtave te perdoruesve në sistem;
- Monitorimi i vazhdueshem i sistemit edhe pas implementimit qe te ruaje performancen pas shtimit te dokumenteve te digjitalizuar dhe te dhenave ne sistem;

3.2. Rrisqet

- Volumi i madh i dosjeve dhe i materialeve të arkivuara mendohet se përbën vështirësi për përfundimin e procedurës brenda afateve kohore të përcaktuara.
- Procesi i digjitalizimit parashikohet të realizohet përmes një sistemi software i cili standardizon mënyrën e indeksimit të materialeve të arkivuara. Kjo procedurë mund të ndikohet negativisht nga mungesa apo mospërputhja e të dhënave të dosjeve për shkak të ndryshimeve në kohë të parashikimeve ligjore/administrative/procedurale që mund të sjellë një proces digjitalizimi jo konsistent.
- Mungesa e akteve normative mbi afatet e ruajtjes së dokumenteve fizik ose elektronik, dhe kryerja e digjitalizimit përpara procesit të asgjësimit nuk bën të mundur evidentimin e dosjeve të cilat kanë mbaruar afatin e ruajtjes, duke sjellë volume dosjesh arkivore fiktive, pra që mund të kalojnë procesin e arkivimit digjital pa qenë e nevojshme.
- Mungesa e metodave të unifikuara të punës në gjykata, do të sjellë sërish problematika në mënyrën e procesimit të dosjeve dhe problematika në indeksimin e akteve në digjitalizim.
- Mungesa e bashkëpunimit ndërmjet aktorëve të përfshirë në këtë proces, mund të sjellë pengesa në realizimin korrekt dhe në kohë të objektivave të procesit.
- Mungesa e bashkëpunimit ndërmjet aktorëve të përfshirë në këtë proces, që mund të sjellë pengesa në realizimin korrekt dhe në kohë të objektivave të projektit;
- Mungesa apo mospërputhjet me ndryshimet ligjore/administrative/procedurale për të qenë konsistent me procesin e ndjekur elektronikisht;

4. QËLLIMI I PUNËS

4.1. Të Përgjithshme

Baza ligjore mbi të cilën mbështetet implementimi i këtij projekti, e cila mundëson realizimin e proceseve që do të automatizohen është:

- Ligji Ligji Nr. 10325, datë 23.09.2010, “Për Bazat e të Dhënave Shtetërore”;
- Ligj nr.9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”
- Ligj n.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”
- Implementimi bazuar në standardet e përgjithshme ndërkombetare për arkivim.

4.2. Hapësira gjeografike që do të mbulohet

Ky sistem do të jetë i bazuar në teknologjinë web, i instaluar në datacenter të Autoritetit Kontraktor.


Akresi i sistemit do të jetë i sigurtë nëpërmjet rrjetit VPN, të krijuar nga AK.

Sistemi do të jetë i përdorshëm dhe i aksesueshëm vetëm brenda rrjetit informatik të Autoritetit Kontraktor.

4.3. Grupet e synuara

Grupet e synuara të këtij sistemi do të jenë do të jenë punonjësit e Autoritetit Kontraktor.

Përdoruesit e sistemit do të kenë mundësi të krijojnë përdorues të tjerë të cilët do të aksesojnë sistemin vetëm nga brenda institucionit rrjetin kompjuterik intranet të brendshëm.



4.4. Siguria e sistemit

Mënyra e logimit ne sistem do te jete me emer perdoruesi dhe fjalekalim. Asnje perdorues nuk mund te aksesojë sistemin pa patur kombinim te saktë perdorues dhe fjalekalim.

Perdoruesit kane te drejta te mirepercaktuara ne sistem sipas rolit qe ata kane. Perdoruesit kane te drejta ne sistem te percaktuara per çdo proces dhe hap ne workflow ku ata kane akses. Perdoruesit qe do te kene rolin e administratorit te sistemit do te kene mundesi qe te administrojne rolet, perdoruesit dhe te drejatat e tyre ne sistem. Ata mund te krijojne, modifikojne e caktivizojne perdoruesit ekzistues. Administratorët gjithashtu mund te konfigurojne fortesine e fjalekalimit sipas standardit te sigurise qe ata do te duan te vendosin ne aksesimin ne sistem.

Sistemi qe do te ndertohet duhet te jete ne perputhje me dispozitat e Vendimit nr. 945, date 02.11.2012, "Per miratimin e rregullores 'Administrimi i sistemit te Bazave te te Dhenave Shteterore'", ne lidhje me disponueshmerine, integritetin dhe konfidencialitetin e sistemit.

Përcaktimi i nivelit të sigurise si dhe disponueshmërinë, integritetin dhe konfidencialitetin e sistemit bazuar në rregulloren e administrimit të Bazave të të Dhënave Shtetërore.

Masa per sigurine:

- Sistemi nuk duhet te lejoje krijimin e llogarive pa password;
- Administratorët nuk duhet te shikojne password-et e perdoruesve, pra ato duhet te ruhen te shifruar ne database;

Opsionet:

- Grupet e perdorueseve do te jene:
 - o Administrator i sistemit;
 - o Perdorues te tjere, te ndare sipas roleve te percaktuara nga Administratori;
- Gjurmimi i veprimeve, detektimi dhe parandalimi i nderhyrjeve, auditimi

Disponueshmëria	Integriteti	Konfidencialiteti	Niveli i Sigurisë
<input type="checkbox"/> D0	<input type="checkbox"/> I0	<input type="checkbox"/> K0	
<input type="checkbox"/> D1	<input type="checkbox"/> I1	<input type="checkbox"/> K1	<input type="checkbox"/> U
<input type="checkbox"/> D2	<input type="checkbox"/> I2	<input checked="" type="checkbox"/> K2	<input type="checkbox"/> M
<input checked="" type="checkbox"/> D3	<input checked="" type="checkbox"/> I3		<input checked="" type="checkbox"/> L

Niveli i sigurisë është i lartë (L), nëse disponueshmëria e të dhënave është D3 ose integriteti i të dhënave është I3.

Niveli i sigurisë është i mesëm (M), nëse disponueshmëria e të dhënave është D2 ose integriteti i të dhënave është I2, ose konfidencialiteti i të dhënave është K2 dhe nuk kërkohet niveli i lartë sipas paragrafit të mësipërm.

Niveli i sigurisë është i ulët (U), nëse disponueshmëria e të dhënave është D1 ose integriteti i të dhënave është I1 ose konfidencialiteti i të dhënave është K1, me përjashtim të rasteve kur niveli i sigurisë është i lartë ose i mesëm, sipas paragrafëve të mësipërm.

4.5. Detyrat specifike

Në këtë pikë është paraqitur një listë e detyrave që duhet të ndërmerren në mënyrë që të arrihen rezultatet e kontratës. Detyrat janë të listuara sipas rëndësisë ose ne menyre

kronologjike. Çdo detyrë kërkon ekspertizë specifike dhe ka të përcaktuar edhe kohën e përfundimit të saj:

Faza e I - Përpilimi dhe dorëzimi i raportit të analizës së biznesit nëpërmjet:

1. Intervistimin e të gjithë kategorive të përdoruesve që mendohet të përdorin sistemin,
2. Analizimin e bazës ligjore dhe të rregulloreve që disponon AK.
3. Analizës së standardeve ndërkombetare të arkivimit.
4. Përpilimin dhe dorëzimin e raportit të analizës së biznesit tek AK.
5. Marrja e aprovimit të raportit të Analizës së Biznesit nga AK.

Faza e II- Levrimi i pajisjeve Hardware, instalimin dhe konfigurimin e tyre

Faza III – Zhvillimit të sistemit software

1. Zhvillimi/implementimi i sistemit të arkivit digjital sipas workflow-ve të bazuar në analizën e biznesit të aprovuar nga autoriteti kontraktor, dhe kërkesa teknike dhe funksionale të parashikuara në këtë dokument.
2. Instalimi dhe konfigurimi i sistemit të arkivit digjital në ambientin test dhe live

Faza IV – Skanimi dhe indeksimi i dokumentacionit në secilen gjykatë.

Faza V - Implementimi i sistemit të manaxhimit të backup

Faza VI - Faza e testimit të sistemit software dhe sistemit të manaxhimit të backup.

1. Testimi i të gjithë moduleve të sistemit të arkivit digjital.
2. Testimi i të gjithë funksionaliteteve të kërkuara nga AK.
3. Testimi i sistemit të manaxhimit të backup.
4. Përpilimi dhe dorëzimi i test case me gjithë rezultatet e testimit
5. Përpilimi i raportit final të testimit.

Faza VII - Trajnimi i përdoruesve

1. Trajnimi i përdoruesve me të gjithë moduleve të sistemit të arkivit digjital.
2. Trajnimi i përdoruesve me të gjithë funksionalitetet e sistemit të arkivit digjital të kërkuara nga AK.
3. Përpilimi i raportit final të trajnimit të përdoruesve.

Faza VIII - Marrja në dorëzim e sistemit dhe akordimi për mënyrën e komunikimit gjatë periudhës së mirëmbajtjes

1. Dorëzimi i sistemit.
2. Dorëzimi i manualeve të përdoruesit.
3. Dorëzimi i dokumenteve teknik, duke përfshirë dhe kodin burim të sistemit.
3. Akordimi për mënyrën e komunikimit gjatë periudhës së mirëmbajtjes dhe nënshkrimi i kontratës së mirëmbajtjes së sistemit .

FAZA IX: Mirëmbajtje

Mirëmbajtje e sistemit sipas dispozitave të VKM - së Nr. 710, datë 21/07/2013, “ Për Krijimin dhe Funkionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit”, për një periudhë 3 vjeçare.



5. LOGJISTIKA DHE KOHA

5.1. Vendndodhja

Vendodhja e sistemit do të jetë pranë zyrave të KLGJ-se.

5.2. Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave

Data e fillimit është data e nënshkrimit të kontratës dhe periudha e e implementimit të detyrave do të jetë deri në 31.12.2024 dhe 3 vjet mirëmbajtja.

6. RAPORTIMI

6.1. Kërkesat e Raportimin

Kontraktuesi do të paraqesë raportet e mëposhtme në <gjuhën> në origjinal dhe <numër (për arsye mjedisore, kërkohet sa më pak kopje të letrës të jetë e mundur)> kopje:

- **Raporti Fillestar** prej maksimumi 20 faqesh duhet të prodhohet pas 1 muaji, nga fillimi i implementimit. Në raport Kontraktuesi duhet të përshkruaj p.sh. gjetjet fillestare, progresi në mbledhjen e të dhënave, çdo vështirësi të pritura ose të hasura përveç programit të punës apo udhëtimeve të stafit. Kontraktuesi duhet të vazhdojë me punën e tij / saj derisa Autoriteti Kontraktues të dërgoj komente mbi raportin fillestar.
- **Drafti i raportit përfundimtar** duhet të perbehet prej 30 faqesh (teksti kryesor, duke përjashtuar anekset). Ky raport duhet të dorëzohet jo më vonë se 1 muaj para përfundimit të periudhës së zbatimit të detyrave.
- **Raporti final** me të njejtat specifika si drafti i raportit përfundimtar, inkorporimin e komenteve të pranuar nga palët në draft raport. Afati i fundit për dërgimin e raportit përfundimtar është 20(njëzet) ditë pas marrjes së komenteve në draft raportin përfundimtar. Raporti duhet të përmbajë një përshkrim mjaftueshëm të detajuar të opsioneve të ndryshme për të mbështetur një vendim të informuar mbi sistemet e implementuara. Analizat e detajuara që i mbështesin rekomandimet do të prezantohen në anekset në raportin kryesor. Raporti përfundimtar duhet të sigurohet së bashku me faturën përkatëse.

6.2. Dorëzimi dhe miratimi i raporteve

Raporti i përmendur më sipër duhet t'i dorëzohet grupit të punës/nëpunësi i ngarkuar për ndjekjen e zbatimit të kontratës të identifikuar në kontratë.

Grupi i punës/nëpunësi i ngarkuar për ndjekjen e zbatimit të kontratës është përgjegjës për aprovimin e raporteve.

AK duhet të realizojë aprovimin e raporteve të mesiperme apo çdo raport tjetër të ndërmjetëm që mund të kërkohej gjatë projektit brenda një afati 5 ditor nga marrja e raportit. Nëse nuk zbatohen këto afate në kohë, atëherë raporti quhet i aprovuar automatikisht dhe vijohet me proceset e radhes.

7. KOMUNIKIMI ME SISTEME TË TJERA

Aktualisht sistemi duhet të integrohet me sistemin e Menaxhimit të Ceshtjeve Gjyqesore. Në sistemin e menaxhimit të ceshtjeve gjyqesore duhet të shtohet një buton ose link që shfaqet në ndërfaqen e ceshtjeve gjyqesore që pasi të klikohet duhet të hapet linku në sistemin e arkives digjitale i cili të çon në dokumentin e vendimit të asaj ceshtjeje nëse ky dokument egziston në arkiven digjitale. Lidhja do të bëhet nëpërmjet numrit të ceshtjes, metadate e cila do të merret gjatë skanimit të dosjeve fizike. Përdoruesi i cili është i loguar në Sistemin e Menaxhimit të Ceshtjeve duhet që të logohet me kredencialet personale në sistemin e arkives digjitale. Parametri i cili duhet të përdoret për të bërë lidhjen me sistemeve është numri i ceshtjes, e dhënë e cila ndodhet si në sistemin e menaxhimit të ceshtjeve ashtu edhe në dosjen fizike e cila do të skanohet dhe ruhet në arkiven digjitale. Sistemi i menaxhimit të ceshtjeve gjyqesore bazohet në teknologjinë .NET, html, javascript dhe Sql Server..

8. GARANCIA

Garancia për sistemin do të jetë 3 vjet duke nisur nga pranimi i sistemit.

9. MIRËMBAJTJA

Mirëmbajtja do të jetë për periudhën kohore 3(tre) vjeçare duke nisur nga pranimi i sistemit. Marrëveshja e shërbimit të mirëmbajtjes së sistemit do të jetë për një periudhë 3 (tre) vite, në përputhje me dispozitat e VKM-së Nr. 710, datë 21 gusht 2013, "Për Krijimin dhe Funksionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit".

Shërbimet e Mirëmbajtjes

Kompania duhet të ofrojë shërbime të mirëmbajtjes sipas kërkesës së përshkruar më poshtë:

- Shërbime të mirëmbajtjes parandaluese.

Suporti i ofruar duhet të përfshijë kontrollin e detyrueshme parandaluese dhe preventivuese, si edhe të përshkruajë dinamikën dhe furnizojë të gjitha detajet teknike mbi aktivitetet e planifikuara.

Monitorimi periodik i rregullt i performancës, i roleve dhe aktivitetit të përdoruesve të software-e. Kompania duhet të nxjerrë raporte pas monitorimeve periodike të cilat duhet të përfshijnë indikatorët e duhur që të japin pamjen e plotë të ecurisë së sistemit në të gjithë komponentët e tij:

- a. Ezaurimit të resourceve hardware
- b. Mos funksionimit të shërbimeve të instaluar në rolet përkatëse
- c. Rritjes së madhësisë së logeve në masën që ndikojnë në performancën e sistemit
- d. Përformancës dhe disponueshmërisë së ulët të sistemit
- e. Vlershmërisë së certifikatave të përdorura.

Izolimi dhe diagnostifikimi i problemeve të thirrura nga service desk për çdo lloj problemi që afekton sistemin. Përgatitja e raportit dhe sugjerimet përkatëse për zgjidhjen e problemit.

Kompania duhet të garantojë suport në rast se një faktor i brendshëm apo i jashtëm afekton sistemin.

Analiza, sugjerimet dhe ndërhyrjet në sistem për zgjidhjen e problemeve duhet të dokumentohen dhe të reflektohen në raportimet periodike.

Kompania duhet të kryejë kontroll periodik javor parandalues monitorues në vendndodhjen e klientit,

Kompania duhet të ofrojë suport lokal 24 x 7 për dhe suport teknik për problemet që mund të shfaqen gjatë periudhës së mirëmbajtjes që nga momenti i nënshkrimit të kontratës. Gjithashtu, duhet të përfshijë asistencën teknike sipas problematikave të ndryshme të shfaqura gjatë punës së përdoruesve (ndërfaqet, proceset, funksionet, etj) në softëare-e.

- Shërbime Riparimi në vendndodhje (mjediset e autoritetit kontraktor/perfituesit) Operatori ekonomik duhet të jetë e disponueshme gjatë intervalit kohor, nga e Hëna në të Premte, 24x7, për të ofruar Shërbime të Riparimit në përgjigje të "Alarmeve Madhore" të raportuara nga personeli i autorizuar ("Emergency On-Call Hours"). Për këtë qëllim, me termin Alarm Madhor do të kuptohet parashtrimi i kërkesës për Shërbime Riparimi të ndërmarra në rast të keqfunksionimit të softëareve apo hardëare të mbuluara, që i pengon ato të operojnë në përputhje me specifikimet dhe shkaktojnë ndërprerje të sistemit.

